



# Gjithë ne jemi fëmijët e kësaj bote:

si duhet të bisedojmë me nxënësit rreth krizës së refugjatëve

# Gjithë ne jemi fëmijët e kësaj bote:

si duhet të bisedojmë me nxënësit rreth krizës së refugjatëve

Të arsimtarë dhe arsimtare,

Përpara jush gjendet publikimi “Gjithë ne jemi fëmijët e kësaj bote: si duhet të bisedojmë me nxënësit rreth krizës së refugjatëve”.

Ky publikim është një përpjekje për të kontribuar që të kuptohet gjendja e rëndë e mijëra njerëzve të cilët për çdo ditë kalojnë nëpër Maqedoni, pranë nesh dhe pranë jetëve tona të përditshme. Në shumë mënyra ata janë fytyra dhe pasqyrimi ynë.

Përpara disa muajve ose një viti as që mund të supozonim se krizë humanitare e këtij lloji do të ndodhte edhe tek ne, që aq numër i madh njerëzish dhe fëmijësh do të jenë të rrezikuar, dhe në nevojë për ndihmë. Nga kalimi i heshtur dhe i pavërejtshëm i refugjatëve nëpër Maqedoni nën strehën e natës, nga ecja me orë të tëra pranë shinave të hekurudhës, e deri tek kampet e mëdha në kalimet kufitare, gjendja e tyre nuk përmirsohet.

Ndihma humanitare është puna e parë dhe më e rëndësishme që duhet bërë. Megjithatë, njëkohësisht është e nevojshme që të bisedohet për atë çfarë është duke ndodhur.

Një numër i madh organizatash, qytetarësh dhe qytetaresh u kyçën dhe dhanë lloje të ndryshme të ndihmës humanitare, duke treguar se nuk kemi harruar se çfarë është solidariteti. Por, për fat të keq, globalisht, refugjatët, sa vjen e më shumë, fillojnë të përjetohen si kërcënim dhe ksenofobija rritet me shpejtësi. Rritet frika nga terrorizmi, nga ndryshimi i pasqyrës demografike, brenga se do të na i marrin vendet e punës, ndikimi mbi kulturën vendase etj.

Është e nevojshme që vazhdimisht të zhvillojmë empati. Pyetjes “përse t’ju ndihmojmë pikërisht refugjatëve kur ka aq shumë qytetarë të Maqedonisë që kanë nevojë për ndihmë?”, duhet të rikujtohem se multikulturaliteti dhe solidariteti nuk guxojnë të kenë kufinj. Të mësojmë dhe të nxisim pranim, bashkëpunim dhe mirëkuptim. Të rinjtë dhe fëmijët ti kyçim dhe të bisedojmë me ta për botën në të cilën jetojmë, për rrënjët e problemeve, për mosbesimin dhe frikën, nga vijnë këto dhe si ti shtjellojmë të njejtat.

Dorracaku është përkthim nga gjuha kroate, në pjesë të caktuara i përshtatur për lexuesit në Maqedoni. konsideruam se do të jetë i dobishëm edhe i zbatueshëm edhe në R. e Maqedonisë për shkak të ngjajshmërisë së konteksteve shoqërore të dy vendeve, si dhe për shkak të vetë problematikës e cila është univërsale. Ju jemi mirënjohës kolegëve dhe miqëve nga Kroacia të cilët na dhanë leje dhe të drejtat për botim. Praktikën e mira nga vende/shtete të tjera duam t’i mbështesim, të na shërbejnë si frymëzim për punën e mëtutjeshme, e në këtë rast edhe si nxitje që ta plotësojmë dorracakun me përvoja nga Maqedonia.

Me kalimin e kohës njerëzit mësohen me gjërat e këqija, pranohet defetizmi, “asgjë nuk mund të bëjmë”, “gjërat janë ashtu siç janë” etj. Hajde të kujtojmë veten se gjithmonë mund të bëjmë diçka më shumë, e shpesh edhe gjërat e vogla mjaftojnë.

Ana Bitoljanu

për ekipin për Arsimim Paqësor pranë Ambasadës së Parë për Fëmijë në Botë- Megjashi

dhjetor, viti 2015



**Titulli:** Gjithë ne jemi fëmijët e kësaj bote: si duhet të bisedojmë me nxënësit për krizën e refugjatëve

**Botuesi:** Ambasada e Parë për Fëmijë në Botë “Megjashi”

**Për botuesin:** M-r Dragi Zmijanac, drejtor egzekutiv dhe themelues

**Autorë:** Forumi për Lirinë e Edukimit

**Përkthyes dhe lektor:** Luljeta Ademi

**Formimi grafik:** Forumi për Lirinë e Edukimit

**CIP-** Katalogim për botimin, Biblioteka Kombëtare dhe Univerzitare “Shën Klimenti i Ohrit”- Shkup

ISBN: 978-608-4603-06-1

Shkup 2015

Këtë publikim vullnetarisht e përpiluan dhe bënë përpunimin grafik punonjësit dhe vullnetarët e Forumit për Lirinë e Edukimit

Propozimet mbi njësitë mësimdhënëse që janë përfshirë me këtë publikim janë bërë me qëllim të mirë, dhe kështu si një bazë u janë ofruar mësuesve dhe arsimtarëve. Ftohen mësuesit dhe arsimtarët që çdo njësi mësimdhënëse të propozuar ta përshtatin sipas moshës dhe njësisë mësimore sipas klasës gjithnjë duke respektuar standardet pedagogjike, metodike dhe didaktike. Forumi për Lirinë e Edukimit nuk mban përgjegjësinë për pasojat e mundshme që mund të shfaqen për arsye të zbatimit joprofesional të këtyre njësive mësimore.

Ky publikim është menduar vetëm për përdorim jofitimprurës dhe për motive mësimdhënëse.

Forumit për Lirinë e Edukimit asesi nuk posedon pronësinë për fotografitë dhe imazhet vizuale që janë përdorur në këtë publikim. Fotografitë e përdorura në këtë publikim janë marrë nga internet faqet e UNICEF-it dhe UNHCR-së.

Pronari i këtij ekzemplari mund të shfrytëzojë cilëndo pjesë për përdorim jofitimprurës dhe për motive mësimdhënëse. Asnjëra pjesë e këtij publikimi nuk guxon të digjitalizohet, përshtatet, përkthehet ose të përfshihet në kompilime të reja pa pëlqimin paraprak të Forumit për Lirinë e Edukimit.





## HYRJE

Në krizën e refugjatëve dhe atë humanitare, brenda së cilës sot gjendet vendi ynë dhe një pjesë e Evropës, ne pyesim veten se në çfarë mënyre fëmijët dhe të rinjtë përjetojnë dhe ndjekin gjithçka që po ndodh rreth tyre?

Të rinjtë dhe fëmijët me siguri se nuk shikojnë aq shumë lajme sesa të rriturit, por ata patjetër ndjekin atë që të rriturit veprojnë dhe për të cilën flasin. Ata krijojnë mendimin e vet, kanë ndjenja, dhe me siguri dhe druajtje. Kriza e refugjatëve me siguri se është një temë, e cila ndikon fëmijët dhe të rinjtë, dhe me siguri se është dhe temë e bisedave të tyre të ndërsjella.

Cilat janë përvojat Tuaja si mësues dhe arsimtarë, si bashkëpunëtorë profesional? A konsideroni se është e nevojshme të flitet rreth këtyre temave në shkollat, komunitetet në të cilat fëmijët qëndrojnë në bazë ditore?

Si të hapim bisedën rreth krizës së refugjatëve me nxënësit? Na ndihmoni që bashkërisht të gjejmë përgjigjet!

Ja pra disa udhëzime të UNICEF-it dhe organizatave tjera që përkujdesen dhe punojnë me fëmijët dhe të rinjtë, kurse ne ju ftojmë t'i ndani përvojat Tuaja me ne:

- Secili këtë gjendje përjeton në mënyrën e vet, ndërkaq, nuk duhet as pakësuar e as shmangur bisedën rreth ndjenjave të tyre.
- Si një person i rritur, dhe, në njëfarë mënyre, model i fëmijës, është me rëndësi të jemi të vetëdijshëm se dhe ne kemi reagimet dhe ndjenjat tona personale të cilat nuk mund t'i fshehim dhe për të cilat do të jetë mirë të vetëdijesohemi.
- Për këtë temë është mirë të bisedojmë me fëmijët dhe të rinjtë nëse ata dëshirojnë këtë, andaj të mos ta imponojmë atë nëse ata për cilëndo arsye

nuk janë të gatshëm dhe të hapur për bisedë.

- Sido që të jetë, ne duhet t'i dëgjojmë ata dhe t'ua bëjmë të ditur se mësuesi/mësuesja do të mund të bisedonte me ta për këtë temë.
- Të gjitha informacionet të cilat do t'u prezantohen fëmijëve dhe të rinjve duhet të jenë të vërteta, dhe kështu, duhet shmangur çfarëdo hamendjesh ose parashtrimesh të paragjyqimeve. Mësuesit duhet të kërkojnë informacione lidhur me gjërat për të cilat nuk kanë njohuri të mjaftueshme. Assesi nuk rekomandohet të shkaktohet panik ose të jepen informacione të cilat nuk janë të verifikuara, por për gjithçka duhet të nisemi nga interesi i fëmijës.
- Fëmijët dhe të rinjtë duhet të njoftohen me gjithë mënyrat me të cilat ndihmohen njerëzit në nevojë, me veprimet humanitare dhe me gjithë mënyrat tjera me të cilat shprehet solidariteti. Nëse nxënësit shfaqin dëshirë që edhe ata vet t'u ndihmojnë të tjerëve, mësuesit duhet të bisedojnë me nxënësit se si bashkërisht do të gjejnë mënyrën e përshtatshme për t'u përfshirë ose për të dhënë kontributin e vet, duke u solidarizuar me njerëzit në nevojë. Kjo, mes tjerash është rast për të rritur empatinë, iniciativën, vlerat humanitare dhe vlera të tjera të shumta me të cilat dëshirojmë të përkrahim tek fëmijët.

Shpresojmë se disa nga idetë në faqet në vijim për ju do të jenë të dobishme në realizimin e mësimdhënies në këtë temë!

Qëllimi i njësive mësimdhënëse në vijim është të zhvillohen njohuri, aftësi dhe vlera në mesin e nxënësve në aspektin e mirëkuptimit të azilkërkuësve dhe migrantëve.

Pas zbatimit të njësive mësimdhënëse në vijim, nxënëset dhe nxënësit do të fitojnë:

**Njohuri:**

- Do të kuptojnë kushtet e vështira dhe sfiduese brenda të të cilave jetojnë fëmijët dhe të rriturit që kërkojnë strehim, se si ata jetojnë dhe si u bëjnë ballë atyre
- Do t'i kuptojnë nevojat elementare të njeriut
- Do të njoftohen me dokumentet kryesore të cilat trajtojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut

**Aftësi:**

- Do të njohin dhe do të nxjerrin faktet e rëndësishme nga teksti i shkruar
- Do të mund të kuptojnë dhe të ndjejnë emocionin e fëmijëve që kërkojnë strehim
- Do të zhvillojnë mendimin kritik
- Do të shfaqin aftësi të shkrimit dhe të shprehurit kreativ

**Vlerat:**

- Respektimi i ndërsjellë dhe respektimi i dallimeve
- Pranimi i stilit të jetesës të ndryshëm nga stili i tyre
- Gjetja e zgjidhjeve të problemeve të cilët nuk poshtërojnë dhe nuk dëmtojnë të tjerët
- Kuptimi real i nevojave elementare të njeriut



# 1. ÇKA I NEVOJITET ÇDO FËMIJE?

**Mosha: 7-11 vjeç**

**Qëllimi:** të njoftohen nxënësit duke bërë dallimin midis nocioneve siç janë dëshirat dhe nevojat, me theks të veçantë mbi refugjatët, të cilët janë shpesh në mungesë të asaj që do t'u kishte mundësuar plotësimin e nevojave elementare jetësore, gjë kjo e cila do të kishte sensibilizuar nxënësit për nevojat e të tjerëve.

**Rezultatet për nxënësit:** ata tanimë dallojnë nocionet siç janë dëshirat dhe nevojat, përkufizojnë dhe përcaktojnë nevojat e veta dhe dëshirat e veta, përshkruajnë nevojat elementare jetësore të cilat janë të rrezikuara në mesin e refugjatëve

**Kohëzgjatja:** 1 orë shkollore

**Materialet që ju nevojiten:**

- Fleta e punës në shtojcë
- Gazeta dhe revista
- Letër A3
- Gërshërë, ngjitës

Video- klip i UNICEF-it: <https://youtu.be/YS791D17jn8>

Vërejtje: Reportazhi i prezantuar ka titra dhe në gjuhën kroate, të cilat duhet të aktivizohen nëpërmjet të shiritit të veglave të YouTube.

**Ecuria e njësisë mësimore:**

Ecuria e njësisë mësimore:

Në fillim të orës nxënësve ua parashtroni një pyetje: Le të ngrenë dorën ata të cilët përpara ditëlindjes së vet ose përpara festave të Krishtlindjeve dhe të Vitit të Ri kanë përpiluar listë të dhuratave, të cilat do të kishin dashur t'i marrin? Me siguri se thuajse gjithë nxënësit do të ngrenë dorën. Disa nga ata le t'u numërojnë se çka kanë shkruar në ato lista. Pyetni nxënësit se çka mendojnë – a kanë numëruar të gjitha dëshirat apo nevojat.

Me ligjërata të shkurtra nxënësve ua definoni dallimin midis dëshirave dhe nevojave.

**Nevoja** është diçka e domosdoshme për jetën tonë, siç është ushqimi, uji, vendbanimi, veshmbathjet, arsimimi, ndjenja e sigurisë, dashuria e të tjera.

**Dëshirat** janë ato gjëra të cilët do të kishim dashur t'i kemi, megjithatë nuk e kemi të domosdoshme për të mbijetuar. Për shembull mund të jenë: ëmbëlsirat, lëngjet, lodrat, telefoni celular, lojërat kompjuterike, e të tjera.

P.sh. Nevoja për ushqim dhe ujë është një nevojë elementare e njeriut, përderisa për shembull çokolata nuk është ajo është një dëshirë.

Pas përkufizimit të nocioneve elementare, ndani nxënësit në grupe dhe ua ndani fletën e punës në shtojcë, si dhe gazeta dhe revista të ndryshme (nëse nuk keni gazeta ose revista, mund të përdorni një propozim të fletës së punës). U thoni nxënësve që nga gazetat/revistat të presin ato fotografi, të cilat mund t'i klasifikojnë në një ose dy kolona (nevojat dhe dëshirat).

Pasi të kryejnë aktivitetin, nxënësit le të prezantojnë fletët e punës. Kërkoni nga ata që t'u shpjegojnë përse disa gjëra kanë renditur nën nevoja, dhe disa tjera nën dëshira. A e kanë patur më të lehtë të gjejnë fotografi të cilat do të karakterizonin nevojat apo dëshirat?

Lusni nxënësit që individualisht të përpilojnë listën e vet të dëshirave dhe nevojave.

Pas kësaj, nxënësve ua prezantoni video- klipin e UNICEF-it (në kohëzgjatje prej 2,5 minutash), ku bëhet fjalë për një vajzë siriane, e cila është në kërkim të strehimit (është refugjate): <https://youtu.be/YS791D17jn8>

Pasi të shikojnë video- klipin, në grupe, le të përpilojnë një listë të nevojave dhe dëshirave të refugjatëve, të cilat mund të identifikohen në këtë film. Pasi të përpilojnë listën, le ta krahasojnë atë me listën e tyre të nevojave dhe dëshirave. Bisedoni rreth asaj nëse ka dallim në atë se çka dëshirojnë ata, e çka dëshirojnë fëmijët në film?

Në fund, lusni secilin nxënës ta plotësojë fjalinë në vijim:

Ajo për të cilën kam nevojë është \_\_\_\_\_, dhe ajo që dëshiroj është \_\_\_\_\_.

# FLETA E PUNËS

DËSHIRAT	NEVOJAT



# FLETA E PUNËS





Zyra e Komisarit të Lartë për Refugjatë (shkurtesa në gjuhën anglishte: UNHCR) është një organizatë ndërkombëtare të cilën e ka themeluar Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 14 dhjetor të vitit 1950. Agjencia vepron në bazë të mandatit të vet për të drejtuar dhe koordinuar operacionet ndërkombëtare të mbrojtjes së refugjatëve dhe zgjidhjes së çështjeve të refugjatëve në tërë botën.

Inkurajoni nxënësit që me ndihmën e Internetit të njihen me punën e kësaj organizate dhe me mënyrat se si ajo ndihmon refugjatët.



## 2. SI JETOJNË FËMIJËT QË KËRKOJNË STREHIM?

**Mosha:** 9-11 vjeç

**Qëllimi:** Të njoftohen nxënësit, duke bërë dallimin midis nocioneve: “refugjat”, “migrant” dhe “kamp refugjatësh”.

**Rezultatet për nxënësit:** bën dallimin midis nocioneve siç janë migrant, imigrant dhe refugjat, zhvillon empati, zhvillon aftësi komunikimi

**Kohëzgjatja:** 1 orë shkollore

**Materialet që ju nevojiten:**

- Fleta pune (definicione) dhe pyetje në shtojcë
- Letër A4
- Kompjuter
- Qasje në Internet
- Reportazh video nga emisioni Indeks i HRT-së: [https://youtu.be/vvib2VP\\_lg4](https://youtu.be/vvib2VP_lg4)
- Videoja e UNICEF-it “Children are more than labels” (kohëzgjatja: 0,32 sek.): <https://youtu.be/uLWcsDfO-SQM>

**Rrjedha e njësisë mësimdhënëse:**

Lexoni me kujdes këto sqarime dhe së bashku në grup përgjigjuni pyetjeve të parashtruara:

*Imigrantët janë njerëz të cilët vinë për të jetuar në një vend tjetër ku nuk kanë lindur. Migrantët janë njerëz që zhvendosen për arsye të ndryshme. Të migrosh do të thotë të largohesh nga një rajon, ose nga një vend në një rajon apo vend tjetër.*

Nxënësve mund t’ua prezantoni një shembull video të emisionit Indeks të HRT-së, që t’i inkurajoni ata për debat: [https://youtu.be/vvib2VP\\_lg4](https://youtu.be/vvib2VP_lg4)

Pyetjet për debat:

- Çka mendon, përse njerëzit largohen nga njëri vend në tjetrin? Në një qytet, vend, shtet tjetër?
- A njuh dikë që është larguar apo ka ardhur në mënyrë të ngjashme? Imagjinoje një fëmijë i cili vjen me prindërit e vet në një vend të ri, në një komunitet të ri? Me çfarë vështirësi mund të përballet ai?
- Si mund t’i ndihmohet kësaj fëmije që të ndjehet i mirëseardhur? Si mund të ndihmohet që ai të ketë sukses më të mirë?
- E, si mund të miqësoheni? Përse do të kishit dashur që të bëheni miq?

*Migrantët janë njerëz të cilët për arsye të punës janë shpërngulur në një vend tjetër. Shumica nga ata pas vete lënë dhe familjet e tyre, ose u dërgojnë para familjeve të tyre për ti ndihmuar ato. Shpesh janë të ndarë nga familjet e tyre për një kohë më të gjatë, nganjëherë dhe për vite me radhë. Disa tjerë zhvendosen për një periudhë sezonale, për shembull për punë në turizëm ose në bujqësi.*

*Megjithatë, nganjëherë njerëzit largohen dhe duke ikur nga lufta, rreziku dhe kushtet tepër të vështira dhe jonjerëzore të jetesës. Nganjëherë vendi i tyre është në gjendje lufte dhe ata dëshirojnë t’i shmangen luftës për shkaqe sigurie të familjes së vet ose për sigurinë e vet personale. Ata i quajmë “refugjatë” ose persona në kërkim të strehimit. Ata përpiqen të gjejnë sigurinë në një vend i cili nuk është në gjendje lufte dhe i cili ofron kushte më njerëzore të jetesës.*

*Megjithatë, nganjëherë ata duhet të udhëtojnë fshehurazi dhe t’u nënshtrihen rreziqeve të shumta. Nganjëherë duhet një kohë të jetojnë në kampe refugjatësh. Jeta e tillë nuk është çdoherë e sigurt e as e këndshme.*



*Në kampet shpesh jetohej në tenda ose në kasolle të vogla. Jo çdoherë është e lehtë të gjesh ushqim ose ujë të pijshëm, energji elektrike. Gjithashtu, njerëzit jo çdoherë janë të sjellshëm dhe mikpritës ndaj tyre.*

A mund ta paramendosh një ditë në një kamp refugjatësh, për një vajzë apo djalë të moshës tënde? Çka do të kishte munguar? Çka do të kishe bërë për ta kaluar ditën? Çka nuk do të kishe mund të bësh?

Punoni në një grup të vogël. Kërkoni në internet dhe në media se si është jeta e fëmijëve në kampe refugjatësh? Atë që do ta mësoni, ndani me grupin tjetër të fëmijëve në shkollë ose në klasë. Shembull: internet faqja e United Nations Refugee Agency ([www.unhcr.org](http://www.unhcr.org)). Nëse ke nevojë, pyete mësuesin apo mësuesen për ndihmë se si duhet rregulluar dhe prezantuar atë që do ta gjesh. Shkruani një letër një personi shumë të rëndësishëm, i cili mund të bëjë diçka për t'i ndihmuar fëmijët që kërkojnë strehim. Lutni atë që të ndihmojë dhe i jepni propozime atij se si mund ta bëjë këtë.

Për fund, mund të prezantoni filmin e shkurtër të UNICEF-it "Children are more than labels" dhe kështu t'i nxisni ata që në mënyrë të pavarur, në shtëpi ose në grup, gjatë orës vijuese, ta bëjnë një afishe me titull "Fëmijët janë fëmijë!", të cilin do të mund ta varni në klasë ose në ndonjë hapësirë tjetër të shkollës.



## 3. KUSH JANË REFUGJATËT?

**Mosha: 9-14 vjeç**

**Qëllimi:** të njoftohen nxënësit me nocionet elementare lidhur me kërkimin e strehimit, t'u prezantohen atyre dokumente të rëndësishme të cilat mbrojnë të drejtat e njeriut të të gjithë njerëzve në planet dhe të sensibilizohen ata rreth gjendjes aktuale të cilën përjetojnë fëmijët dhe të rinjtë anembanë botës.

**Rezultatet për nxënësit:** bëjnë dallimin midis kërkimit të strehimit dhe migrimit, përkufizojnë nocionet siç janë kërkimi i strehimit dhe migrimi, Përkruajnë rëndësinë e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, rrisin ndjenjën e empatisë

**Kohëzgjatja:** 1 – 2 orë shkollore

**Materialet që ju nevojiten:**

- Letër A4
- Shënues
- Letër A3
- Reportazh video të UNICEF-it: <https://youtu.be/YS791D17jn8>

**Vërejtje:** Reportazhi i lartpërmendur ka titra në gjuhën kroate, të cilat duhet aktivizuar në shiritin e veglave të YouTube.

**Rrjedha e njësive mësimore:**

Ndani nxënësit në grupe. Në një letër A4 le të numërojnë disa arsye se përse njerëzit largohen nga shtëpitë e tyre drejt qyteteve, shteteve, kontinenteve tjera.

Pasi të shënojnë të gjitha arsyet, nxënësve u ndani nga një letër në të cilën gjenden dy kolona. Në kolonën e parë nxënësit duhet t'i shënojnë arsyet për të cilat njerëzit largohen vullnetarisht, ndërsa në kolonën tjetër arsyet për të cilat njerëzit largohen në kundërshtim me vullnetin e vet. Secili grup le t'i radhitë arsyet të cilat paraprakisht kishin shkruar sipas kësaj ndarjeje.

Secili grup le të varë afishen e vet në një pllakë dhe le t'ia prezantojë atë pjesës tjetër të klasës.

Në po të njëjtat grupe, tani nxënësit në mënyrë të pavarur le të definojnë nocionin "refugjat". Secili grup le t'ia prezantojë pjesës tjetër të grupit përkufizimin e vet. Në diskutim duhet që e tërë klasa të bie dakord për një përkufizim të përbashkët.

Pas kësaj, ua ndani nxënësve Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe i nxisni ata të gjejnë brenda saj artikuj që kanë të bëjnë me refugjatët dhe të tregojnë se në cilën mënyrë mbrohen të drejtat e njeriut të refugjatët. (Posaçërisht të rëndësishme këtu janë nenet 13 dhe 14.)

Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut mund ta shihni këtu:

[http://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR\\_Translations/aln.pdf](http://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf)

**REFUGJAT është një i/e huaj, i/e cili/cila nuk gjendet në vendin e shtetësisë së vet dhe për arsye të frikës së bazuar nga persekutimi për shkak të racës, fesë, kombësisë, përkatësisë një grupi të caktuar shoqëror ose të mendimit politik, nuk mund ose për shkak të asaj frike nuk dëshiron të vihet nën mbrojtjen e atij vendi. Gjithashtu refugjati është një person pa shtetësi i cili gjendet jashtë vendit të banimit të zakonshëm dhe i cili nuk mund ose për shkak të frikës së bazuar nuk dëshiron të kthehet në atë vend. Është ky emri i përbashkët për gjithë personat që kërkojnë dhe/ose shfrytëzojnë ndonjë lloj të mbrojtjes.**

Si aktivitet përfundimtar, ua prezantoni nxënësve reportazhin video të UNICEF-it për vajzën siriane Aya e cila është në kërkim të strehimit. Pasi që nxënësit të shohin reportazhin në kohëzgjatje nga 2,5 minuta, le ta marrin një copë letër dhe laps dhe le t'i shkruajnë një letër vajzës Aya. Nëse bëhet fjalë për fëmijë më të vegjël, ata mund të shprehen edhe me vizatim. Me rëndësi është nxënësve t'u jepet kohë dhe liri e mjaftueshme që të jenë sa më kreativ.





هيا

ينا

نسجيل في

المدارس



الله  
نور





## 4. GJITHË NE JEMI FËMIJË

### Mosha: 11 – 18 vjeç

(nxënësit e moshës më të hershme mund të shprehen me vizatim, ndërsa tekstet mund t'u lexohen atyre)

**Qëllimi:** Zhvillimi i ndjenjës së bashkësisë me gjithë qeniet njerëzore dhe ndërkaq, aftësia e rritja e empatisë ndaj refugjatëve

**Rezultatet për nxënësit:** të njohin ngjashmëritë dhe dallimet midis gjithë fëmijëve të botës, të njohin ngjashmëritë me vajzat refugjate, të zhvillojnë aftësi për rritje të empatisë ndaj refugjatëve

**Kohëzgjatja:** 1 orë shkollore

### Materialet që ju nevojiten:

- Letër A4
- Shënues
- Letra A4 me fotografi dhe historive të vajzave refugjate

### Ecuria e njësisë mësimore:

Në fillim të orës mësimore, ndani nxënësit në çifte dhe secilit çift i jepni nga një letër A4. U sqaroni nxënësve se detyra e tyre është që duke përdorur formën e diagramit të Venit, të gjejnë ngjashmëritë dhe dallimet mes vete, brenda çiftit. Pas këtij aktiviteti, disa nxënës le të lexojnë ngjashmëritë/dallimet që kanë veçuar.

Pyetni nxënësit nëse kjo detyrë ka qenë e vështirë për ata dhe nëse kanë menduar se si me dikë brenda klasës do ta kenë të vështirë të gjenin ngjashmëri. Me bisedë, udhëhiqni nxënësit drejt konkluzionit sesi të gjithë ne mes vete për disa gjëra dallohemi, por dhe kemi shumë gjëra të përbashkëta.

Tani i paralajmëroni nxënësit se do ta bëjnë të njëjtin aktivitet individualisht, por “me” personin të cilin do ta fitojnë në letër. Ndani me secilin nxënës një letër me fotografi dhe histori e cila shoqëron fotografinë (materialet merrni në adresën e internetit: <http://ja-miefrancis.com/blog/2013/11/17/syrian-refugees-school-girls-in-exile>, zgjidhni histori të cilat i konsideroni të përshtatshme sipas moshës së nxënësve tuaj).

Pas aktivitetit, u sqaroni nxënësve se si gjithë kanë marrë nga një histori të vajzave refugjate nga Siria.

Në anën e pasme të letrës, nxënësit le të vizatojnë Diagrame të Venit dhe në ato le të shënojnë ngjashmëritë dhe dallimet që do të njohin me leximin e tekstit që kanë marrë.


Pyetni nxënësit nëse kanë njohuri rreth nocionit refugjatë dhe rreth krizës së refugjatëve.

Nxënësit le të lexojnë ngjashmëritë/dallimet që kanë veçuar. Jini të gatshëm për atë se disa nga nxënësit nuk do të gjejnë ngjashmëri në mënyrë të pavarur, dhe është detyra juaj që me bisedë ose me shembujt e nxënësve tjerë t'i nxisni ata që t'i konstatojnë ngjashmëritë në vijim: ne jemi qenie njerëzore, jemi fëmijë, duam të shoqërohemi me shokët, duam familjet tona, duam qytetin/mëmëdheun tonë, kemi plane dhe ëndrra që dëshirojmë t'i bëjmë realitet; ndjehemi të frikësuar/të pafuqishëm...

Me bisedë nxisni nxënësit që të vinë në përfundim se si gjithmonë duhet orvatur ta kuptojmë situatën në të cilën gjendet personi tjetër, ta vëmë veten në pozitën e tyre, pasi të gjithë ne jemi fëmijë/njerëz që kemi dëshirat, ëndrrat, nevojat, frikët, të drejtat tona. Nxisni nxënësit që të reflektojnë se si mund t'u ndihmojnë fëmijëve që kanë nevojë për ndihmë, dhe në këtë rast – refugjatëve. Shënoni propozimet në dërrasë.

Nëse bëhet fjalë për nxënës më të rritur, propozojmë të shikoni filmin vizatimor, i cili shpjegon se si është krijuar kriza e refugjatëve (Youtube: The European Refugee Crisis and Syria Explained)

# FLETA E PUNËS



# FLETA E PUNËS



Unë jam Azari dhe jam 14 vjeçe. Jam lindur në Homs të Sirisë. Kemi arritur në Jordani më 03.01.2013 për shkak të luftës në Siri. Jam shumë e pikëlluar pasi shumë njerëz në vendin tim janë vrarë dhe shokët e mi më mungojnë shumë. Këtu nuk jam fare e lumtur, pasi nuk i kam pranë shokët dhe familjarët e mi. Shumë njerëz kanë vuajtur. Jeta këtu është e vështirë.



Unë jam Noor dhe jam 15 vjeçe. Dua të bëhem mjekë, madje kirurge, dhe kjo do të ishte shumë e dobishme për vendin tim dhe mendoj se është me rëndësi të punojë diçka të dobishme. Në Jordani arritëm në shkurt të vitit 2013.



Unë jam Julanar nga Siria. Më së shumti më mungon shpendi im. Do të kisha dëshirë të këndoja. Dhe të fluturoja përreth dhomës sime. Më mungojnë shokët dhe koha kur kemi lozur dhe kur kemi qeshur. Kur të rritem dua të bëhem inxhinierë ose arkitekte. Dua t'i ndihmoj vendit tim që të rindërtohet. Jam 14 vjeçe.



Unë jam Daiana dhe jam 15 vjeçe. Vija nga qyteti i okupuar Homs. Më mungon shumë, rruga ime, shokët e mi, shkolla ime. Përpara kam kaluar shumë kohë me shokët, kam mësuar, kam lozur dhe kam qenë e buzëqeshur. Nuk është e lehtë ta falësh, dhe askush nuk mund ta bëjë këtë, përveç nëse bën përpjekje. Dëshira ime është që lufta të përfundojë sa më shpejt dhe të mund të kthehemi në Siri dhe vendi të ndërtohet sërish dhe të bëhet i fuqishëm. Dua t'i ndihmoj të tjerët në mësim dhe dua të bëhem mësuese, dhe kështu ta ndihmoj vendin tim. Këtu kam arritur diku ka mesi i vitit 2012.









## 5. NOCIONET

**Mosha:** 15 – 18 vjeç

**Qëllimi:** të njihen nxënësit me nocionet elementare në lidhje me krizën e refugjatëve

**Rezultatet për nxënësit:** të kuptojnë dhe të përshkruajnë nocionet elementare në lidhje me krizën e refugjatëve, të bëjnë dallimin midis shprehjes së fakteve nga interpretimi personal, të vetëdijesohen rreth paragjytimeve personale kur flasim për krizën e refugjatëve

**Kohëzgjatja:** 1 orë shkollore

**Materialet që ju nevojiten:**

- Letër A4
- Shënues
- Letër A3

**Burimi:** <http://goo.gl/E8b6Qg>

**Rrjedha e njësisë mësimdhënëse:**

Ndani klasën në 4 grupe dhe secilit grup ia shpërndani nocionet në vijim:

- Grupi 1. REFUGJAT, AZILKËRKUES, AZILANT DHE AZIL
- Grupi 2. MBROJTJE SUBSIDIARE, MBROJTJE E PËRKOHSHME, I HUAJ
- Grupi 3. PADREJTËSI SERIOZE, PARIMI “NON-REFOULEMENT” (NDALIMI I MOSKTHIMIT)
- Grupi 4. RREGULLORJA E DUBLINIT, IMIGRANTË JO TË RREGULLT, MIGRANTË/ MIGRIME
- Grupi 5. ZHVENDOSJE (resettlement), RISISTEMIM (relocation)

Secili grup shpall kuptimin e vet të nocioneve që ka marrë dhe bën prezantimin nëpërmjet të pllakës së prezantimit përpara pjesës tjetër të klasës.

Zhvilloni një bisedë me nxënësit duke parashtruar pyetje:

- Çfarë nuk kam ditur më parë?
- Ç’është ajo që më ka befasuar?
- Ajo që nuk e kam të qartë...
- Ku mund të gjej më tepër informacione?
- A mund të konstatoj se kur jam duke shpallur fakte (si këto nocione të përcaktuara me ligj), e kur mendim?
- A është e vështirë të prezantohen këto fakte pa përfshirë qëndrimin personal lidhur me këto nocione? Përse?

# FLETA E PUNËS

## GRUPI 1

REFUGJAT është një i/e huaj, i/e që nuk gjendet ne vendin e shtetësisë së vet dhe për shkak të frikës së bazuar nga persekutimi për shkak të racës, fesë, kombësisë, përkatësisë një grupi të caktuar shoqëror ose mendimit politik nuk mund apo nuk dëshiron të vihet në mbrojtjen e atij vendi. Refugjat është dhe një person pa shtetësi, i cili gjendet jashtë vendit të banimit të zakonshëm, dhe i cili nuk mund ose për shkak të frikës së bazuar – nuk dëshiron të kthehet në atë vend. Është ky emri i përbashkët për gjithë personat që shfrytëzojnë ndonjë lloj të mbrojtjes.

AZILKËRKUESI/AZILKËRKUESJA është një person i huaj, i cili me hyrje në Republikën e Maqedonisë (ose në ndonjë vend tjetër) parashtron kërkesë për azil dhe gjatë kohës së shqyrtimit të kërkesës gjendet brenda vendit. Personat që kërkojnë azil kryesisht janë vendosur në Qendrat e Pranimit të Azilkërkuesve – godina këto që shërbejnë për sistemim kolektiv (një të tillë ka psh. në Vizbeg, në afërsi të Shkupit)). Nëse azilkërkuesi ka mjete financiare personale me të cilat mund të paguajë akomodimin ose familjarë apo miq të cilët janë të gatshëm për t'i pranuar ata – atëherë mund të akomodohen tek ata, duke lajmëruar paraprakisht Ministrinë e Punëve të Brendshme, e cila është kompetente për procedurën e kërimit të azilit. Azilkërkuesit nuk kanë kufizime të lëvizjes dhe mund të akomodohen kudo në territorin e RM-së.

AZILANT është refugjat të cilit i është lejuar azili në bazë të dispozitave të Ligjit mbi Azilin.

AZILI paraqet dhënien e mbrojtjes dhe strehimit që një vend i caktuar i mundëson në territorin e tij një personi i cili ka braktisur vendin e vet për shkak të frikës së bazuar nga persekutimi, gjegjësisht, pasi i janë rrezikuar të drejtat bazë të njeriut. Azili nuk ka dhe nuk mund të lejohet në bazë të shkaqeve ekonomike, përveç të atyre politike. Refugjatët gëzojnë të drejtën për të kërkuar azil, përderisa migrantët nuk e gëzojnë këtë të drejtë.

## GRUPI 2

MBROJTJE SUBSIDIARE paraqet mbrojtje e cila i lejohet të huajit/të huajës i cili/e cila nuk plotëson kushtet për dhënie të azilit, dhe për të cilin/të cilën ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat dëshmojnë se me kthimin në vendin e origjinës do të përballen me rrezikun e vuajtjes së padrejtësive serioze.

MBROJTJE E PËRKOSSHME u lejohet të huajve të cilët në një numër të madh po arrijnë në Maqedoni nga vendi në të cilin për shkak të luftës (ose gjendjes së ngjashme me luftën), të dhunës së përgjithshme ose konflikteve të brendshme është shkaktuar cenimi i të drejtave të njeriut. Kjo formë e mbrojtjes miratohet për shkak të jogatishmërisë ose pamundësisë së vendit të origjinës për të ofruar mbrojtje, si dhe nëse për një numër të madh të personave nuk do të jetë e mundur në mënyrë efektive të zbatohet procedura e miratimit të azilit në interes të të gjithë personave që kërkojnë mbrojtje.

I HUAJ është një person me shtetësi tjetër, dhe për nga pikëpamja e shtetasvemaqedonas, person i cili nuk ka shtetësi të Maqedonisë.

## GRUPI 3

PADREJTËSIA SERIOZE nënkupton kërcënim me dënim me vdekje/eliminim, torturim, veprim jonjerëzor/poshtërues ose dënim dhe kërcënim individual të jetës për shkak të dhunës arbitrare në konfliktet e armatosura ndërkombëtare ose të brendshme.

PARIMI “NON-REFOULEMENT” (NDALIMI I MOSKTHIMIT) paraqet parimin bazë të definuar me Konventën mbi Statusin e Refugjatëve të vitit 1951. Mbron refugjatët që do të ndodhin në territorin jashtë vendit të origjinës nga kthimi i detyruar në territorin ku ekziston probabiliteti se do të persekutohen, torturohen ose vriten. Neni 33 i Konventës lexon: “Asnjë vend nënshkrues nuk guxon të dëbojë e as të kthejë një refugjatë në asnjë mënyrë, aty ku jeta ose liria e tij do të ishin rrezikuar për arsye të përkatësisë së tij racore, fetare ose kombëtare ose për arsye të përkatësisë një grupi të caktuar shoqëror ose për arsye të mendimit politik.”

# FLETA E PUNËS

## GRUPI 4

RREGULLORJA E DUBLINIT paraqet një Rregullore të Këshillit të BE-së me të cilën është definuar kompetenca e vendeve anëtare të BE-së në lidhje me procedurën e kërkimit të azilit brenda vendit anëtar të BE-së. Rregullorja e Dublinit përfshin nocionin “ndarja e barrës” në përbërjen e përbashkët të azilit të BE-së, që do të thotë se personi i cili do të kërkojë azil në një vend anëtar, këtë gjë nuk mund ta bëjë dhe në një vend tjetër anëtar. I tërë procesi mbështet PËRBËRJEN EURODAC – bazë kjo e të dhënave e BE-së, me gjurmët e gishtave të azilkërkuarit. Kur dikush kërkon azil, pavarësisht se ku gjendet brenda BE-së, gjurmët e tij të gishtave futen në përbërjen qendrore të EURODAC-it, me të cilën bëhet e dukshme se në cilin vend ky person ka kërkuar azil për të parën herë.

IMIGRANTË JO TË RREGULLT janë ata të huaj të cilët në RM kanë hyrë pa dokumente të vlefshme dhe të cilët nuk kanë për qëllim të kërkojnë azil ose ndonjë lloj tjetër të lejes së qëndrimit. Termi më i zakonshëm për kësaj personash është imigrant i paligjshëm ose ilegal, por nga pikëpamja e të drejtave të njeriut, është e gabueshme njeriun ta emëroni si ilegal, ose joligjor. Asnjë person nuk mund të jetë i paligjshëm (ilegal) – të paligjshëm mund të jenë vetëm veprat ose sjelljet e tij. Personat që do të kapen në kalim ilegal të kufirit ose qëndrim ilegal në territorin e RM-së, do të sistemohen në Qendrën e Pranimet të të Huajve, i cili është me karakter të mbyllur.

MIGRANTË/MIGRIME – me nocionin “migrime” nënkuptojmë lëvizjen fizike të njerëzve nga njëri rajon në tjetrin, më së shumti nëpër distanca të mëdha dhe/ose në grupe të mëdha. Për dallim nga nocioni “refugjat”, i cili nënkupton njerëzit të cilët për shkak të konflikteve të luftës janë dëbuar nga shteti i vet, nocioni “migrantë” u referohet personave që kanë vendosur të shpërngulen në ndonjë rajon tjetër për shkak të dëshirës për një jetesë më të mirë.

## GRUPI 5

SHPËRNGULJE (resettlement) është një proces i kërkimit të azilit, brenda të cilit personi banon në një vend, ndërsa procedura e kërkimit të azilit po zbatohet në një vend tjetër. Kur personit i lejohet azili, ajo zhvendoset nga vendi ku ka qëndruar gjatë kohëzgjatjes së procedurës së azilit në vendin i cili i ka lejuar mbrojtje ndërkombëtare.

RIVENDOSJE (relocation) është një proces i përbërjes së përbashkët të azilit të BE-së, i cili përfshin zhvendosjen e azilkërkuarit nga njëri vend anëtar i BE-së në një vend tjetër anëtar të BE-së, me të cilën vendi anëtar po bëhet përgjegjës për procedurën e kërkimit të azilit.





**FËMIJËT REFUGJATË  
DUHET SA MË SHPEJTË TË  
INKUADROHEN NË ARSIM,  
DHE KËSHTU T'U OFROHET  
SIGURIA.**



## 6. MITE DHE FAKTE

**Mosha: 15 – 18 vjeç**

**Qëllimi:** Të ndihmohen nxënësit për të identifikuar dhe për të thyejtë mitet më të shpeshta rreth krizës së refugjatëve të cilat mund të dëgjohen në media dhe përreth

**Rezultatet për nxënësit:** të identifikojnë mitet rreth krizës së refugjatëve, të kuptojnë dhe përshkruajnë faktet mbi krizën e refugjatëve, të vetëdijesohen për paragjykimet personale rreth refugjatëve dhe imigrantëve

**Kohëzgjatja:** 1 orë shkollore

**Materialet e nevojshme:**

- Letër A4
- Shënues
- Letër A3

**Ecuria e njësive mësimore:**

Në murin e klasës le të ngjitet një letër A3 ku do të shkruajë PAJTOHEM, dhe në murin përballë le të ngjitet një letër në cilën shkruan NUK PAJTOHEM. U sqaroni nxënësve se do të lexoni një deklaratë lidhur me krizën e refugjatëve dhe ata do t'i afrohen anës përkatëse, varësisht nëse pajtohen me deklaratën, ose nuk pajtohen.

Pasi ta lexoni çdo deklaratë dhe pasi që nxënësit të pozicionohen, kërkoni nga disa nxënës nga secili grup të shpjegojnë qëndrimin e tyre. U jepni mundësi të ndryshojnë pozitën pasi kanë dëgjuar njëri nga tjetri. Pastaj ua lexoni faktet lidhur me secilën deklaratë dhe pasi që ta dëgjojnë atë, u mundësoni atyre që nëse dëshirojnë, mund ta ndryshojnë pozitën e vet.

Me rëndësi është të pranohen të gjitha mendimet, duke parafrazuar atë që është thënë “të pastrohet” gjuha nga fjalët fyese dhe duke u thirrur në rregullat e komunikimit brenda klasës.

Bëni një diskutim me ata duke ua parashtruar pyetjet në vijim:

- Si keni krijuar mendimin tuaj? Në bazë të cilave informacione? Nga kush dhe ku keni dëgjuar ato informacione?
- Zakonisht, si krijojmë një mendim për diçka? A përipiqemi t'i kuptojmë të gjitha informacionet, apo krijojmë mendimin duke dëgjuar të tjerët?
- A i keni ditur këto fakte? A ju kanë befusuar?
- A mendoni se do të kishit mundur të hulumtoni pak më tepër rreth fakteve mbi krizën e refugjatëve, që ta keni më të qartë për të krijuar mendimin tuaj?
- Ku mund të gjenden të gjitha informacionet?
- Çka mendoni – përse disa njerëz krijojnë mite si këto?
- A keni dëgjuar për mite tjera, si për shembull, për njerëzit e rinj (“të rinjtë janë përtac”), Muri Kinez (“shihet nga Hëna”), “demat vrapojnë pas ngjyrës së kuqe” (demat nuk dallojnë ngjyrat, reagojnë në emocionet e toreadorit), etj.
- Sa është e vështirë të thyhen mitet pasi të pranohen nga shumica e njerëzve? Përse?



# FLETA E PUNËS

## **MITI 1. Azilkërkuesit kanë të drejta më të mëdha dhe jetë më të mirë se ne.**

Azilkërkuesit kanë shkallë shumë më të ulët të të drejtave në krahasim me shtetasit e Maqedonisë. Përderisa po qëndrojnë në Maqedoni, azilkërkuesve u është siguruar një qëndrim grupor në Qendrën e Pranimit të Azilkërkuesve, si dhe kushtet elementare për jetesë: tre vakte të ushqimit në ditë, veshmbathje, gjëra të nevojshme higjienike, ndihmë urgjente mjekësore dhe kurim të duhur të sëmundjeve, arsimim fillor dhe të mesëm për fëmijët, ndihmë falas juridike, ndihmë humanitare dhe liri të ushtrimit të fesë, si dhe edukim fetar për fëmijët etj. Të drejtën e punës do të fitojnë pas një viti nga dorëzimi i kërkesës për azil, dhe nëse deri atëherë nuk kanë marrë një vendim nëse do t'u lejohet azili, apo jo. Jetesa me njerëz të panjohur me të cilët ndani një dhomë të vogël me të drejta dhe mjete financiare minimale nuk mund të konsiderohen si kusht dinjitoz për jetën e njeriut. Siguria, privatësia dhe familja janë disa nga gjërat të cilat azilkërkuesit më së shumti i theksojnë se u mungojnë.

## **MITI 2. Azilkërkuesit janë gënjeshtarë të cilët dëshirojnë ta shfrytëzojnë mikpritjen tonë.**

Azilkërkuesit janë persona që janë detyruar të braktisin shtëpitë e tyre për shkak të rrezikut për jetën personale dhe për shkak të sigurisë. Të ikësh nga shtëpia jote dhe të arrish në një vend të panjohur dhe të fitosh azil nuk është një gjë e lehtë dhe e thjeshtë. Që dikush të fitojë azil duhet kaluar nëpër një procedure të caktuar (atë e zbaton Ministria e Punëve të Brendshme dhe gjykatat administrative), e cila përbëhet nga ekzaminimi i detajuar i identitetit, arsyet e ikjes dhe pamundësia e kthimit në vendin e vet. Azilkërkuesit shpresojnë për kushte të sigurt dhe dinjitoze të jetesës dhe dëshirojnë të vazhdojnë jetën e vet në një ambient të ri, duke pritur mundësitë e njëjta si secili nga ne.

## **MITI 3. Azilkërkuesit po qëndrojnë këtu në mënyrë ilegale.**

Secili azilkërkues ka qëndrim të paraqitur dhe dokument me të cilin dëshmon identitetin e vet. Disa nga azilkërkuesit kanë hyrë në RM pa dokumente (të vlefshme), por megjithatë, me parashtrimin e kërkesës për azil pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, statusi i tyre po bëhet ligjor dhe fitojnë të drejtën e qëndrimit në territorin e RM-së. Hapi i parë të cilin personi që dëshiron të kërkojë azil duhet ta bëjë është që në vendkalimin kufitar ose në stacionin policor, apo drejtorisë t'ia tregojë qëllimin e vet për kërkim të azilit. Pas kësaj, fillon procedura e ndërlikuar e ekzaminimit të bazës së arsyetimit të kërkesës së azilkërkuesit nga ana e zyrtarit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

## **MITI 4. Azilkërkuesit do të na i marrin vendet tona të punës.**

Azilkërkuesit fitojnë të drejtën e punës madje një vit pasi kanë dorëzuar kërkesën për azil nëse brenda atij afati nuk kanë pranuar vendimin e lejimit apo hedhjes poshtë të azilit. Madje dhe kur ta fitojnë të drejtën e punës, as atëherë ata nuk realizojnë këtë të drejtë me kushte të njëjta si shtetasit maqedonas, por si të huaj. Numri i rasteve të tilla të cilat arrijnë që të punësohen në R. e Maqedonisë është shumë i vogël dhe praktikisht as që mund të bëhet statistikë. Duke patur parasysh që më së shpeshti këto persona nuk e flasin gjuhën maqedonase, apo gjuhët e tjera të vendit, shanset se do të punësohen janë shumë të vogla.

## **MITI 5. Azilkërkuesit sjellin në RM sëmundje të reja ngjitëse.**

Kjo nuk është e vërtetë, mbrojtja shëndetësore e azilkërkuesve është rregulluar në përpikëri me Ligjin mbi Azilin. Me këtë dokumente është përcaktuar që pas arritjes në Qendrën e Pranimit të Azilkërkuesve, azilkërkuesit do të kalojnë një kontroll të mjekut, ndërsa në rast se vinë nga vende të cilat janë të rrezikshme për këtë çështje, ata do të kalojnë këqyrje dhe vëzhgime plotësuese mjekësore.

## **MITI 6. Azilkërkuesit marrin mbështetje financiare të madhe.**

Në Republikën e Maqedonisë azilkërkuesit, tani për tani, nuk marrin mbështetje financiare. Në shtete të tjera ku këto të drejta janë të rregullara më mirë me ligj, azilkërkuesit marrin mbështetje financiare simbolike [p.sh. në R. e Kroacisë ata fitojnë 100 kuna (rreth 800 denarë) në muaj, dhe jo të gjithë, por vetëm ata azilkërkues që nuk kanë mjete financiare dhe ata azilkërkues, shpenzimet e jetesës të të cilëve nuk janë siguruar në mënyrë tjetër, si dhe ata që nuk gjenden në marrëdhënie pune. Kjo shumë përcaktohet në shumë nga 15-13% të shumës bazë së ndihmës sociale të cilën marrin shtetasit kroat.)

## **MITI 7. Azilkërkuesit e kanë patjetër t'i përshtaten kulturës sonë dhe mënyrës sonë të jetesës.**

Secili gëzon të drejtën e zgjedhjes së lirë të jetesës dhe kulturës, përderisa nuk ua rrezikon këto të drejta të tjerëve. Është me rëndësi që secili, pra kështu dhe azilkërkuesit, të kanë të drejtën e mirëmbajtjes, zhvillimit dhe shprehjes së kulturës vetjake, zbatimit dhe shprehjes së identitetit të vet kulturor, si dhe të drejtën e ruajtjes së traditës. Kultura nuk është e lehtë për ta harruar e as për t'iu përshtatur një kulture tjetër të ndryshme, e posaçërisht jo për një kohë aq të shkurtër përderisa azilkërkuesit po qëndrojnë në Qendrën e Pranimit.

# FLETA E PUNËS

## **MITI 8. Azilkërkuesit rrezikojnë sigurinë tonë (ecin në grupe dhe nuk flasin gjuhën tonë).**

Kjo nuk është e vërtetë, azilkërkuesit, sipas treguesve të sigurisë me të cilat udhëhiqet MPB-ja, ata nuk kanë kontribuar për rritjen e veprave ndëshkuese dhe penale në ato mjedise në të cilat jetojnë dhe kështu, sipas këtyre treguesve, mund të vijmë në përfundim se nuk bëhet fjalë për frikën objektivi- sht të bazuar për sigurinë, por bëhet fjalë vetëm për një frikë subjektive. Veç kësaj, azilkërkuesve, me rastin e sistemimit në Qendrën e Pranimi, u janë marrë shenja të gishtave dhe mbahet llogaria për sigurinë e të gjithë qytetarëve të RK-së. Më së shumti frika e shprehur kundrejt azilkërkuesve është fakti se ata ecin në grupe. Por, është shumë e thjeshtë arsyeja e cila shpjegohet për këtë – ata në këtë mënyrë ndjehen më të sigurt, duke ditur se nuk kuptojnë gjuhën kroate e as nuk janë mjaftueshëm të familjarizuar me shoqërinë në të cilën kanë arritur. Shumica e tyre dëshiron të mësojë nga njerëzit dhe institucionet e mirëfillta dhe kështu, sa më shpejtë të përshtateten..

## **MITI 9. Azilkërkuesit do të vërshojnë RM-në dhe do të shkatërrojnë gjuhën dhe fenë tonë.**

Azilkërkuesit në Republikën e Maqedonisë përfaqësojnë një grup të marginalizuar dhe pakicë, e cila në kurrfarë mënyre nuk rrezikon gjuhën maqedonase apo gjuhët e tjera e as fetë e qytetarëve të saj. Shumica e azilkërkuesve dëshiron ta mësojë gjuhën maqedonase për të qenë në gjendje të komunikojnë me qytetarët e Maqedonisë, të punësohen dhe të bëhen pjesëtarë të plotfuqishëm të shoqërisë maqedonase. Kushtetuta e RM-së u siguron lirinë e bindjes fetare, dhe është me rëndësi se në mesin e tyre ka ithtarë të të gjitha grupeve fetare si dhe ateistë.

## **MITI 10. Së pari duhet të kujdesemi për tanit, e pastaj për të tjerët.**

“Të vendosësh t’u ndihmosh atyre që kërkojnë strehim në shoqërinë tanë është shumë e ngjashme me vendimin e kapitenit të anijes që të mos shpëtojë të humburit në det, pasi ai po nxiton për të arritur qëllimin” (Hugo Grotius). Një numër i konsiderueshëm i maqedonasve, shqipëtarëve, turqve etj në sistemin e kaluar e sidomos gjatë viteve të fundit të tranzicionit dhe periudhës së konflikteve kanë kërkuar azil dhe/apo strehim ose kanë shkuar në gurbet në vende tjera. Është kjo një gjë e cila na bashkon me këta individë – ndajmë një përvojë të njëjtë. Kjo përvojë pra do të duhej, në mesin “tonë”, të qytetarëve të Maqedonisë, të shkaktojë solidaritet me azilkërkuesit dhe azilkërkueset, si dhe mirëkuptim ndaj gjendjes dhe jetës së tyre.

## **MITI 11. Azili është për kafshët.**

Azili paraqet mbrojtje me të cilën realizohen dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë lidhje me ofri-

min e strehimit të refugjatëve në Republikën e Maqedonisë. Në kuptimin e plotë të fjalës– e drejta e azilit nënkupton mbrojtjen e personalitetit njerëzor nga kërcënimet dhe rrezikimi. Fjala azil gjen origjinën e vet në gjuhën greke, që do të thotë strehë, strehim, zabel dhe mbrojtje. Rrënjët e të drejtave të azilit mund të gjenden tek një numri të madh të popujve antik, përfshirë këtu dhe egjiptianët, grekët dhe hebrenjtë. Ata popuj kanë konsideruar këtë si një obligim (fetar) të vetin, dhe kështu nuk ua kanë ndaluar azilin madje as kriminelëve ose personave të akuzuar për krim, duke i mbrojtur ata nga pasojat ligjore deri në një kufi të caktuar. Në përbërje, azili përfaqëson ofrimin e strehës dhe kështu, në këtë kuptim, ky nocion është përdorur edhe në rastet kur streha u është ofruar kafshëve të braktisura.

## **MITI 12. Kush janë ata dhe përse janë këtu?**

Azilkërkuesit largohen në vende tjera për të kërkuar strehim për arsye se në vendin e banimit të tyre të zakonshëm, jeta e tyre është rrezikuar, gjegjësisht, ndiejnë frikë të bazuar nga persekutimi për shkak të racës, kombësisë, përkatësisënjë grupi të caktuar shoqëror ose për shkak të mendimit politik.

## **MITI 13. Azilkërkuesit janë të varfër.**

Kur personi ik nga diçka ose nga dikush që ua rrezikon jetën, ai as nuk mendon për para, stoli, laptop ose sende tjera me vlerë, të cilat do të kishin mund t’i posedonin – por ai ik vetëm për të shpëtuar kokën. Disa individë arrijnë të marrin me vete disa nga gjërat materiale, por disa jo. Kështu që, nuk mund të flasim në përgjithësi për tërë grupin. Edhe pse janë në numër të ulët, në mesin e azilkërkuesve në RM ka patur individë që vinë nga familje të pasura dhe familjet e tyre kanë ndihmuar ata financiarisht për të vazhduar jetën e tyre në Maqedoni.

## **MITI 14. Gjithë refugjatët vinë në Evropë**

Më se 80% nga 59 milionë refugjatë anembanë botës mbeben afër vendit të vet të origjinës. Nga njëra anë, ata shprejnë për kthim të shpejtë në shtëpitë e tyre, dhe nga ana tjetër, nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare për të ikur më tej. Numri më i madh i refugjatëve nga zonat e luftës të Sirisë dhe Irakut gjenden në vendet fqinje të Sirisë – në Lindjen e Afërt. Zyra e Komisarit të Lartë për Refugjatë (UNHCR) për momentin vlerëson se numri i refugjatëve sirian në vendet fqinjë arrin diku rreth 4.08 milionë. Vetëm 348,000 kërkesa për azil janë parashtruar në Evropë.

Burimet:

- <http://www.cms.hr/hr/azil-i-integracijske-politike/mitovi-o-azilantima-i-traziteljima-azila>
- <http://www.dw.com/en/dispelling-myths-about-refugees/a-18680503>

Burimet:

- [www.unhcr.org](http://www.unhcr.org)
- [www.unicef.org](http://www.unicef.org)
- [www.cms.hr](http://www.cms.hr)
- <http://www.cms.hr/hr/azi1-i-integracijske-politike/mitovi-o-azilantima-i-traziteljima-azila>
- <http://www.dw.com/en/dispelling-myths-about-refugees/a-18680503>
- [www.hrt.hr](http://www.hrt.hr)
- <http://jamicfranciscan.com/blog/2013/11/17/syrian-refugees-school-girls-in-exile>
- <http://learningtogive.org/teachers/>
- UNICEF Youtube channel: <https://www.youtube.com/channel/UCZceliiH710Lw4t4HcvKKjw>

## RECENZION I LIBRIT “GJITHË NE JEMI FËMIJË TË KËSAJË BOTE”

Kam nderin që të rekomandoj për botim dhe për përdorim në sistemin arsimor librin “Gjithë ne jemi fëmijë të kësajë bote”, të përgatitur nga Ambasada e Parë për Fëmijë në Botë Megjashi, në bashkëpunim me Forumin për Lirine e Edukimit nga Kroacia. Ky botim është tejet i rëndësishëm dhe i nevojshëm për të rinjtë tanë dhe për arsimimin paqësor në përgjithësi, si aspekt jashtëzakonisht i rëndësishëm për edukimin e të gjithë njerëzve sot.

Me vetëdijen për egzistencën e problemeve edhe të njerëzve të tjerë, si dhe me kujdesin ndaj tyre, në thelb më së miri shprehim se kemi kujdes edhe për veten, sepse me dy anët e lidhura të veprimit moral tregojmë se jemi njerëz të vërtetë. E mira që bëjmë do të thotë respekt për të tjerët, e njëkohësisht është edhe shprehje e dinjitetit personal dhe realizimit të vetëvetes si person i përgjegjshëm dhe i ndershëm.

Ky është kuptimi i etikës, ashtu siç i nevojitet botës, jetës tonë dhe ardhmërisë së njerëzimit në përgjithësi. Etika do të thotë mendimi i drejtë, përzgjedhja e përgjegjshme e asaj që është e vlefshme dhe e virtytshme. Kundrejt kësajë është përgjumësia përpara përgjegjësisë, mbyllja e veshëve përpara gjërave të këqija dhe të bërit keq, sidomos kur është e nevojshme që të bëhet diçka e mirë. Etika sot është shumë e rëndësishme, për ruajtjen e Natyrës dhe përparimin e mjedisit jetësor, për kuptimin e nevojave të botës, për përmirësimin e gendjeve të këqija dhe për qetësimin e konflikteve të cilët i trondisin njerëzit.

Etika e re ka shumë arritje/çaqe të rëndësishme. Etika univerzale ndërtohet me vlera morale të njejta për të gjithë njerëzit, ajo do të thotë përdorim i të gjitha mësimëve më të vlefshme të të gjitha popujve, nga të gjitha epokat, nga të gjitha fetë dhe nga personat më të mençur. Këtë e demonstroi edhe libri “Gjithë ne jemi fëmijë të kësajë bote”. Bioetika i kujton njerëzit se kemi një botë, të cilën duhet ta ruajmë në të gjitha format e shfaqjes në jetë, tek njerëzit dhe qenjet e tjera të gjalla. Arsimi etik është një mënyrë e re e edukimit që të rinjtë të zhvillohen në persona të pjekur dhe autonom, të cilët do të jenë të përgjegjshëm për obligimet e tyre morale dhe që do të sillen në mënyrë të drejtë me të tjerët. Kah këto detyra është i kthyer ky libër. Vlera themelore dhe më e madhe e këtyre tre dhe mësimëve të tjera bashkëkohore etike të Paqes, nuk është vetëm gjendje pa konflikte, por përjetim i brendshëm i orientimit të çdo njeriu që ti kuptojë të gjitha problemet e rëndësishme dhe të shmangë dhunën ndaj të tjerëve. Etika na mëson se kujdesi për të tjerët, për të gjitha qeniet e gjalla, është karakteristika dhe veprimi më i mirë i secilit prej nesh.

Në libër potencohet njëra nga metodat e reja morale, Empatia, ndjeshmëria për gjendjen, hallet dhe vuajtjet e të afërmeve, të çdo krijese. Të afërmit janë të gjithë njerëzit për të cilët duhet të jemi të vetëdijshëm që egzistojnë gjithandej rrotull nesh, nëpër tërë botën, dhe të cilët kanë të njejtin përjetim të egzistencës si të gjithë ne. Ata duhet ti duam dhe ti konsiderojmë për motra dhe vllazër tanët. Poqese deri më tani nuk i kemi takuar- e kemi jetuar dhe jemi shoqëruar me mijëra të tjerë rreth nesh- tani kemi mundësinë që të takojmë shumë të afërt, e më vonë, ndonjëherë, edhe të vendosim baza për mirkuptim të ndër-sjellë dhe për afërsi të veprimeve të përbashkëta.

Për këtë gjë flet bukur shembulli i Nënës Terezë, bashkëqytetare e jona nga Shkupi, bëmirsja më e njohur në tërë Globin. Fillimisht u përkushtua për arsimimin e të rinjëve, e më pastaj për bamirësi për të sëmurët dhe të mjerët në qytetin më të vobegët në botë, Kalkutën e Indisë. Ju ndihmonte që të mbijetojnë, të shërohen, të ndjejnë dinjitet kur dikush i do, ajo ndërtoi spitale, strehimore dhe shkolla, tërhoqi mijëra ndjekës dhe bamirës që ta mbështesin në këtë punë të rëndë. Ajo në mënyrë modeste tregoi “Nuk mund të bëjmë gjëra të mëdha, por gjërat e vogla mund ti bëjmë me dashuri të madhe”. Ky është rekomandimi më i mirë të cilin ua dha njerëzve, përsëri shembullit dhe referencës se atyre që vuajnë duhet ndihmuar gjithsesi. Shembulli dhe fjalët e Nënës Terezë janë thelbi për të gjithë njerëzit e mirë në botë.



Libri “Gjithë ne jemi fëmijë të kësaj bote” flet në një mënyrë moderne për nevojën që ti kuptojmë refugjatët që vijnë kah Evropa nga ngjarjet e tmerrshme në Lindjen e Mesme, ngjarje këto, të cilat e trondisin vetëdijen dhe ndërgjegjjen e të gjithë qytetarëve këto ditë. Ata janë të shumtë në numër dhe të varfër, kërkojnë strehim dhe vend të sigurt për të jetuar. Shumë nga ata janë gra dhe fëmijë të të gjitha moshave, të cilët në mënyrë të trishtë e kishin patjetër që të lëshojnë shtëpitë e tyre dhe të nisen nëpër botë në kërkim të lumturisë dhe mbijetesës në paqe. Këto janë elemente të të drejtave të të gjithë njerëzve, të cilat janë të shprehura në Deklaratën Univerzale për të Drejtat e Njeriut. Ky dokument i OKB-ës nga viti 1948 është deklarata e parë e përbashkët e të gjithë njerëzve me vullnet të mirë pas dy luftave të mëdha të tmerrshme se duhet të ndryshojnë pikëpamjet dhe sjelljen e njerëzve. Me Deklaratën filloi një etapë e re në Tokë, sepse deri atëherë njerëzit ishin kryesisht të pabarabartë dhe nuk mbahej llogari për plotësimin e dëshirave dhe nevojave e shumicës së qenieve njerëzore. Prej atëherë e deri më sot, e prej këtu e deri në ardhmëri, për njerëzit është e rëndësishme që të jetojnë me vetëdije për këto të drejta dhe duhet patjetër që të plotësojnë ndërgjegjshëm detyrën themelore që ti mbrojnë këto të drejta për vete, por edhe ti plotësojnë kushtet që këto të drejta ti ketë çdo banorë i planetit tonë.

Ambasada e Parë për Fëmijë në Botë Megjashi e plotëson funksionin fisnik që ti udhëzojë fëmijët që ta njohin botën në të cilën jetojnë, që t’ju ndihmojë fëmijëve që të realizojnë të drejtat dhe nevojat e tyre dhe të krijojnë lidhje mes fëmijëve nga të gjitha anët dhe të gjithë popujt që të duhen dhe respektohen dhe të veprojnë së bashku në zgjidhjen e çështjeve të ndërlikuara të egzistencës së tyre, rritjes dhe bashkëpunimit. Për më të rinjtë tanë, sot, ata janë edhe problemet, të cilat përpara syve të tyre, i kanë fëmijët dhe njerëzit refugjatë nga zonat e luftës.

Ambasada e fëmijëve Megjashi, përkaj kyçjes së drejtpërdrejtë në ndihmën e refugjatëve, gjithashtu u rrek të merret me arsimimin etik dhe paqësor me librin “Gjithë ne jemi fëmijë të kësaj bote”, që të rinjtë tanë të jenë të udhëzuar në ato probleme të vështira, të kuptojnë se çfarë është duke ju ndodhur të rinjëve në atë ekzod të tmerrshëm dhe që të nxisë ndjenjën e empatisë për vështirësitë dhe vuajtjet e refugjatëve, sidomos të refugjatëve të rinjë, moshatarëve të tyre. Si në shumë raste deri më tani, kjo do të ndihmojë tek të rinjtë tanë, si dhe tek e tërë bashkësia në përgjithësi, që të zhvillohet ndjenja e solidaritetit me të përvuajturit dhe të ngrihen aksione për të ndihmuar në çështjet e tyre jetësore dhe morale.

Andaj, me gjithë zemër zotohem për botimin dhe përdorimin në arsim të librit “Gjithë ne jemi fëmijë të kësaj bote”, sepse në botën e re të ndërlidhur fëmijët duhet të kenë mirëkuptim për të gjithë fëmijët.

D-r Kiril Temkov,  
profesor i rregullt i Etikës

